


Prot. 24 636/2

**TP** TashkoPustina

**Nga:** Av. Florian Hasko  
Tashko Pustina  
Blv. "Dëshmoret e Kombit"  
Kullat Binjake, nr.24, Kati 2<sup>o</sup>  
1019 Tirane



Tirane, me 06.10.2022

**Për:** Qendra Kombëtare e Biznesit  
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë  
Tel +35542250066  
E-mail: info.qkb@qkb.gov.al

**Lenda:** Kërkese për publikimin e vendimit nr. 14261/6617 date 06.06.2022 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga gjyqtari z. Julian Haxhiu në emër të shoqërisë EHW-KRIPA Sh.a.

Të nderuar Zonja/Zoterinjt!

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar çështja civile me kërkues E.H.W Sh.p.k. dhe z. Luan Leka ("Kërkuesit") për prishjen e shoqërisë aksionare EHW-KRIPA Sh.a. ("Shoqëria") dhe fillimin e procedurave të likuidimit, aktualisht në gjykim nga gjyqtari Julian Haxhiu ("Çështja"), siç vërtetohet nga vendimi lëshuar nga kjo gjykate këtu bashkëlidhur.

Pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), është depozituar Vendimi Nr.14261/6617 Regj.them, datë 06.06.2022, protokolluar nga QKB me Nr. 24636 Prot., datë 22.09.2022, me objekt: "Prishjen e shoqërisë "E.H.W-KRIPA" SHA dhe caktimin e likuidatorit, z. Edvin Gaçe".

Duke qenë se, në vendimin e sipërcituar nuk ishin të përcaktuara të dhënat e likuidatorit, QKB-ja me anë të shkresës Nr. 24636/1 Prot., datë 29.09.2022 i është drejtuar gjykatës për të kërkuar të dhënat e identifikimit të z. Edvin Gaçe, me qëllim regjistrimin e vendimit të sipërcituar pranë regjistrimit tregtar.

Duke u nisur nga përgjigja juaj, për lehtësimin dhe vijueshmërin e procedurës së publikimit të vendimit në ekstraktin e shoqërisë EHW-KRIPA Sh.a. ("Shoqëria"), po jua vemë në dispozicion të dhënat e z. Gaçe, bashkëlidhur kërkesës.

Duke ju falenderuar për vëmendjen tuaj, shpresojmë në ndihmën dhe mbështetjen tuaj për të zgjidhur këtë situatë.

Mbetemi në pritje të përgjigjes suaj,

Sinqerisht,

Av. Florian Hasko

Përfaqësues me autorizim



## AUTORIZIM

Tirane, me 15 korrik 2021

Une, i nenshkruari, Mërkur Leka shtetas shqiptar, lindur me 25.12.1963 ne Tiranë, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit nr. 034841537 ne cilesine e Administratorit te shoqerise **E.H.W Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Shqiperi, me NUIS J61804031V, me seli te regjistruar ne adresen Superstrada Tirane-Durres, Km. 4.8 Tirane, Shqiperi ("**Shoqeria**") leshoj kete Autorizim per:

- **Z. Florian Hasko**, lindur me 14.06.1982, ne Tirane, banues ne Tirane, me Licence Avokatie Nr. 3078 dhe/ose **Znj. Kozeta Speci**, lindur me 09.09.1979, banuese ne Tirane, me License Avokatie Nr. 9864 dhe/ose **Bjorni Vasili**, lindur me 15.06.1991, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, me License Avokatie Nr. 9260 ("**Perfaqesuesit**"), te cilet kane te drejte:

te perfaqesojne Shoqerine bashkerisht ose vec e vec, ne lidhje me proceduren gjyqesore me kerkues Luan Leka, E.H.W Sh.p.k., ose cdo kerkues tjetër/person i interesuar, sipas rastit, me objekt prishjen e shoqerise aksionare EHW KRIPA Sh.a., me NUIS K81914035R dhe per rrjedhoje fillimin e procedurave te likujdimit dhe caktimin e likujduesit, si edhe heqjen e emrave te anetareve te keshillit te administrimit nga regjistri tregtar per shkak te perfundimit te afatit te mandatit te tyre dhe cdo ceshtje tjetër sipas objektit te kerkeses dhe cdo ceshtje tjetër ne lidhje me prishjen dhe likujdimin e shoqerise EHW KRIPA Sh.a. ("**Çeshtja**"), perpara Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, si edhe perpara çdo gjykate tjetër kompetente te cdo shkalle gjykimi, perfshire Gjykatën Kushtetuese, ose perpara cdo organi kompetent shteteror, sipas rastit.

Perfaqesuesit do te veprojne ne emer dhe per llogari te Shoqerise duke ushtruar te gjithë mjetet ligjore sipas legjislacionit te zbatueshem, me qellim permbushjen e qellimit te mesiperm.

Per keto arsye, Perfaqesuesit autorizohen qe ne emer dhe per llogari te Shoqerise te pergatisin, te nenshkruajne dhe te depozitojne shpjegime me shkrim, prapesime, te pergatisin, hartojne, nenshkruajne dhe paraqesin, padi, kerkesa, deklarate mbrojtjeje, kunderpadi, te ngrene pretendime, te parashtrrojne kunderpretendime e kerkesa procedurale pa asnje kufizim dhe te plotesojne e te nenshkruajne aplikime apo çdo dokument tjetër qe ato do te konsiderojne te pershtatshem, te paraqesin prova dhe nese e nevojshme te kerkojne marrjen e provave sipas menyrave qe parashikohen nga Kodi i Procedures Civile me ndryshime dhe ne pergjithesi te ushtrojne te gjithë mjete ligjore pa asnje kufizim per mbrojtjen e interesave te mia qe ato e konsiderojne te nevojshem ne perputhje me ligjin si edhe te ndryshojne, saktesojne, pakesojne ose shtojne objektin, bazen ligjore dhe shkakun ligjor, te paraqesin kerkesa per sigurimin e padise, ose çfaredolloj kerkese tjetër per marrjen e masave te sigurimit, per leshimin e urdherit te ekzekutimit, per dhenien e vendimit me ekzekutim te perkohshem, te heqin dore teresisht apo pjeserisht nga kerkesa, padia, ankime apo te tjera qe Perfaqesuesit do e konsiderojne te pershtatshme, perfshire cdo kerkese per pushimin e gjykimit apo heqjen dore nga e drejta e kerkeses, padise, te paraqesin kerkesa per ekzekutimin e vendimeve te gjykates, perfshire urdher ekzekutimin, perfshire çdo vendim gjyqesor qe do te jepet nga gjykatat e te gjithë shkalleve dhe



nese e nevojshme te pergatisin, te nenshkruajne dhe te depozitojne ankim, kunderankim perpara Gjykates se Apelit dhe rekurs apo kunderrekurs prane Gjykates se Larte.


Perfaqesuesit do te veprojne me te gjitha tagrat ligjore, ose do te kryejne cdo veprim tjetër i cili edhe pse nuk permendet shprehimisht ne kete Autorizim, kryerja e tij eshte e nevojshme dhe/ose e domosdoshme per permbushjen e qellimeve te ketij Autorizimi, perfshire cdo veprim perpara Qendres Kombetare te Biznesit, si dhe perpara cdo autoriteti tjetër publik apo privat per regjistrimin e cdo vendimi gjyqesor, padie, shenimi, deklarimi, kerkim informacioni, praktike, dokumente, dosje, etj, si dhe per kryerjen e çdo lloj veprimi tjetër pa asnje kufizim perpara çdo organi publik apo privat ne Republiken e Shqiperise.

Çdo veprim i kryer prej Perfaqesuesve ne permbushje te sa me siper konsiderohet si i kryer prej Shoqerise dhe ky Autorizim eshte i vlefshem deri ne revokimin e tij.

**Per shoqerine E.H.W. Sh.p.k.**

**Mërkur Leka**

*Mërkur Leka*  
Administrator



E.H.W.  
SUPERSTRADA TIRANË - DURRES km 5  
Tel.(04) 3560055 (048)200711; Fax.(04)357 663,(048)200341  
NIP J61804031V





Nr. 14261/6617 Regj.them.  
Data e regjistrimit 27.07.2021

Datë 06.06.2022

### VENDIM

### “NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e rrethit gjyqesor Tiranë, e përbërë nga:

**Julian HAXHIU – Gjyqtar**

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Klaudia ABAZAJ**, sot me date 06.06.2022, perfundoi ne seance gjyqesore me dver te hapura, ceshtjen civile me Nr. 6617, qe i perket:

#### KERKUES:

1. Luan Leka, shtetas shqiptar, lindur me 06.01.1954, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit nr. 036754781, dhe nr. personal F40106079, banues ne Rr. "Ibrahim Rugova", P. 64, Tirane, Shqiperi, Tirane, perfaqesuar me Prokure te Posacme nga Av. Florian Hasko.

2. E.H.W. Sh.p.k., Superstrada Tirane-Durres, Km. 4.8 Tirane, Shqiperi, perfaqesuar me Autorizim nga Av. Florian Hasko.

#### OBJEKTI:

Prishjen e shoqërisë aksionare EHW-KRIPA Sh.a., e regjistruar rregullisht prane Qendres Kombetare te Biznesit, me date 14.07.2008, me NUIS K81914035R dhe me seli ne adresen Kashar, Superstrada Tirane-Durres, Km 4, Stabilimenti EHW, Tirane, Shqipëri

Fillimin e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftwsise paguese për shkak të prishjes së shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., sipas pikës 1 të objektit të kesaj kerkese dhe caktimin e likujduesit.

Dërgimin Qendres Kombetare te Biznesit te vendimit per prishjen e shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., e ndjekur nga percaktimi “shoqeri ne likujdim” dhe caktimin e likujduesit sipas pikave 1 dhe 2 te objektit te kesaj kerkese dhe urdherimin e Qendres Kombetare te Biznesit te heqi emrat e administratorit dhe anetareve te keshillit te administrimit te shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., nga regjistri tregtar per shkak te perfundimit te afatit te mandatit te tyre.

**BAZA LIGJORE:**



Neni 334/dh i Kodit te Procedures Civile i ndryshuar, neni 187, 190 të Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Neni 51 i ligjit Nr.9723, date 05.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor të kërkesës, si më lart, pasi dëgjoi palën kërkuese Luan Leka e cila përfundimisht kërkoi pranimin e kërkeses sipas objektit;

**VËREN**

EHW-KRIPA Sh.a eshte nje shoqeri aksionare e regjistruar rregullisht prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me date 14.07.2008, me NUIS K81914035R dhe me seli ne adrosen Kashar, Superstrada Tirane-Durres, Km. 4, Stabilimenti EHW, Tirane, Shqiperi ("Shoqeria" ose "EHW KRIPA"), sipas ekstraktit tregtar te Shoqerise leshuar nga QKB ("Ekstrakti Tregtar"). Ekstrakti Tregtar,

Shoqëria, sipas Ekstraktit Tregtar dhe statutit te saj është themeluar nga tre aksionare si vijon:

- (i) Z. Rigel Gjonaj, shtetas shqiptar, lindur me 11.03.1982, ne Vlore, Shqiperi, banues ne lagjen "Lef Sallaku", Vlore Shqiperi me 30,00 % te aksioneve te Shoqerise ("Z. Gjonaj");
- (ii) Z. Luan Leka, shtetas shqiptar, lindur me 06.01.1954, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr. "Ibrahim Rugova", P. 64, Tirane, Shqiperi, me 60,00% te aksioneve te Shoqerise ("Z. Leka");
- (iii) E.H.W. Sh.p.k., regjistruar prane QKB-se me NUIS J61804031V, me seli ne adresen: Superstrate Tirane-Durres, Km. 4.8 Tirane, Shqiperi, me 10,00% te aksioneve te Shoqerise ("E.H.W.").

Shoqëria EHW-KRIPA Sh.a ka kaluar ne status pezullimi te aktivitetit te saj ne vitin 2015, per shkak mungese aktiviteti tregtar ne Shqiperi, sipas ekstraktit tregtar leshuar nga QKB, Gjithashtu, në pamundësi për t'u thirrur dhe mbledhur në mënyrë të rregullt, asambleja e aksionareve te Shoqerise nuk ka marre me asnje vendim per Shoqerine, por as organet drejtuese te Shoqerise, administratori dhe anetaret e keshillit te administrimit nuk jane mbledhur me, per shkak se mandati i tyre ka perfunduar prej kohesh dhe asnjeri prej tyre nuk ka ushtruar me asnje funksion prej atij casti.

Shoqëria EHW-KRIPA Sh.a për keto arsye, nuk ka mundur që të emerojë administratorin dhe anetaret e rinj te keshillit te administrimit duke vazhduar te mbaje te regjistruar ne QKB administratorin dhe anetaret e keshillit te administrimit pavaresisht se ata nuk ushtrojne me asnje funksion per shkak te perfundimit te afatit te emerimit ne detyre.

Për këto arsye, kërkuessit i janë drejtuar gjykates si persona te interesuar me kerkese për prishjen dhe fillimin e procedurave te likuidimit, sipas objektit te saj, ne baze te Nenit 187 te



Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar"), me objektin si vijon:

1. Prishjen e shoqerise aksionare EHW-KRIPA Sh.a., regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 14.07.2008, me NUIS K81914035R, me seli ne adresen Kashar, Superstrada Tirane-Durres, Km 4, Stabilimenti EHW, Tirane, Shqiperi.
2. Fillimi i procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese per shkak te prishjes se shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., sipas pikes 1 te objektit te kesaj kerkese dhe caktimin e likujduesit.
3. Dergimin Qendres Kombetare te Biznesit te vendimit per prishjen e shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., e ndjekur nga percaktimi "shoqeri ne likujdim" dhe caktimin e likujduesit sipas pikave 1 dhe 2 te objektit te kesaj kerkese dhe urdherimin per heqjen e emrave te administratorit dhe anetareve te keshillit te administrimit te shoqerise EHW-KRIPA Sh.a., nga regjistri tregtar per shkak te perfundimit te afatit te mandatit te tyre

Në lidhje me parashikimet ligjore Gjykata veren se:

Në nenin 187 të Ligjit Tregtar parashikohet se:

*"1. Shoqeria aksionare prishet:*

*c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;*

*[...]*

*3. Ne rast mosveprimi te asamblese se aksionareve per te vendosur prishjen, sipas rasteve te parashikuara nga shkronjat [...] "c", [...] te pikes 1, te ketij neni, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, ne çdo kohe, per te konstatuar prishjen e shoqerise;*

*[...]"*

Në rastin e kësaj shoqërie ndodhemi përpara situatës ligjore parashikuar nga paragrafi 1, germa "c", dhe paragrafi 3 i Nenit 187 të Ligjit Tregtar, përderisa që prej viti 2011 nuk funksionojnë me organet e Shoqërisë, asambleja e aksionareve të Shoqërisë nuk therritet dot ne menyre te vlefshme, qe eshte dhe kusht per funksionimin dhe vendimmarrjen e rregullt nga Shoqeria dhe te pakten qe prej 2015 Shoqeria ka kaluar ne status pezullimi duke mos kryer me asnje veprimtari tregtare. Rrjedhimisht, objekti i Shoqërisë është bërë i pamundur, duke përmbushur per keto arsye kerkesat e gernes "c" te paragrafit 1 te Nenit 187 te Ligjit Tregtar.

Në pamundwsi për të mbledhur asamblenw e aksionareve tw Shoqwrise, kwrkuesi nw cilwsine e tyre respektivisht si aksionar mazhoritar (zotërues me 60,00% te kapitalit) dhe aksionar minoritar (zotwrues me 10,00% te kapitalit) te Shoqerise, legjitimohen qw t'i drejtohen gjykates me kerkese per prishjen e Shoqerise, ne baze te paragrafit 3 te Nenit 187

te Ligjit Tregtar. Kërkesit janë për këto arsye, personat e interesuar ligjërisht për rregullimin e pasojave ligjore që vijnë nga pamundësia për vazhdimin e aktivitetit tregtar të një subjekti i cili nuk funksionon më, të pakten prej vitit 2015, sic provohet nga depozitimet ne Ekstraktin Tregtar te Shoqërisë

Në këto rrethana, për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të Shoqërisë, moskryerjes të asnjë veprimtarie tregtare, objekti i Shoqërisë është bërë i perealizueshem dhe rrjedhimisht ekzistojnë të gjithë shkaqet ligjore te parashikuara nga paragrafi 1, germa "c", dhe paragrafi 3 i Nenit 187 te Ligjit Tregtar per prishjen e Shoqërisë.

*A. Fillimi i procedurave te likuidimit dhe caktimi i likujduesit*

Në nenin 188 të Ligjit Tregtar parashikohet se:

- “1. Administratoret jane te detyruar te regjistrojne prishjen e shoqërisë prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".*
- 2. Nese prishja behet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes ex officio.”*

Nëse rregulli është që janë administratoret e shoqërisë që i njoftojnë prishjen e saj QKB-se, në këtë gjykim, ky njoftim duhet të bëhet nga gjykata, në rastin që kjo pranon piken 1 të kërkesës. Për më tepër, aktualisht Shoqëria nuk ka administratore dhe nuk ka asnjë organ që mund të përmbushë ndonjë detyrim të tillë.

Në këto rrethana, Neni 189 të Ligjit Tregtar parashikohet se:

- “me përjashtim të rasteve kur eshte nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë aksionare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri ne 205 te ketij ligji.”*

Për sa më sipër, në bazë të Nenit 192 (Emerimi i likuiduesve nga gjykata) te Ligjit Tregtar, me marrjen e vendimit per fillimin e procedurave te likuidimit te Shoqërisë, gjykata dotë caktojë likujdesin e saj. Gjithashtu, njëjtë sipas parashikimit të paragrafit 2 te Nenit 188 te Ligjit Tregtar, edhe ne rastin e caktimit të likujduesit nga gjykata për shkak të prishjes së shoqërisë me vendim gjykate, është po kjo e cila i njofton QKB-se emrin dhe tagrat e likujduesit të caktuar për këtë qëllim.

Në neni 194 të Ligjit Tregtar, parashikohet se:

- “1. [...] Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per regjistrimin e biznesit".*
- 2. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "ne likuidim."*

Për këto arsye, gjykata këtë vendimin për caktimin e likujduesit do t'ia percjelle QKB-se për regjistrim sipas Nenit 45 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Gjithashtu, me regjistrimin e këtij vendimi, emërtimi i Shoqërise duhet të jetë si vijon: "EHW-KRIPA Sh.a. - shoqeri ne likujdim".

Me caktimin dhe regjistrimin e likujduesit, të gjithë tagrat për administrimin e Shoqërisë dhe përmbushjen e veprimeve për likujdimin e saj i takojnë likujduesit, sipas neneve 190 e vijues të Ligjit Tregtar.

Duke qene se mandati i anëtarëve të këshillit të administrimit ka përfunduar prej kohësh dhe Shoqëria nuk ka funksionuar prej vitesh administratori dhe tre anëtarët e tjerë të këshillit të administrimit nuk mundet që t'i drejtohen personalisht QKB-se për largimin e tyre, pra fshirjen e emrave të tyre nga regjistri tregtar në lidhje me Shoqërinë.

Kërkuesi ka kërkuar që njëkohesisht me regjistrimin pranë QKB-se të vendimit të gjykatës për prishjen e Shoqërisë dhe likujduesin e Shoqërisë për shkak të fillimit të procedurave të likujdimit, të urdherojë gjithashtu QKB-ne të largojë, pra të fshijë emrat e administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit të Shoqërisë nga regjistri tregtar për shkak të përfundimit të afatit të mandatit të tyre.

Gjithashtu është paraqitur informacion në lidhje me adresën e aksionarit Rigel Gjonaj ku janë kryer njoftimet në lidhje me këtë kërkesë, në të cilën megjithatë nuk është arritur ta njoftojmë, shkak për të cilin ka qenë e pamundur marrja e kontaktit me të dhe njoftimet në lidhje me ecurinë dhe nevojat për funksionimin e Shoqërisë. Pra, sic provohet edhe nga pamundësia për t'u vene në kontakt me Z. Gjonaj, vërtetohen shkaqet e ngritura nga ana kërkuesit për prishjen e Shoqërisë.

Në përfundim, pas analizës së faktit, pretendimeve të palës kërkuese, analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se kërkesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Prishja e shoqërisë tregtare vijohet nga procesi i likujdimit, përmes të cilit shlyhen të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve dhe ndahet teprica e likujdimit mes ortakeve apo aksionerëve, sipas raportit të pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë. Ky operacion tregtar mund të realizohet përmes procedurave ligjore të likujdimit të zakonshëm ose likujdimit të thjeshtëzuar. Likujdimi i thjeshtëzuar përfaqëson një procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë likujdimi, në rastet kur shoqëria tregtare nuk ka detyrimeve ndaj të tremeve dhe mes ortakeve apo aksionerëve nuk ekzistojnë mosmarreveshje për procesin e likujdimit, në ndryshim nga procedura e zakonshme, në të cilën detyrimet e shumta të shoqërisë ndaj kreditorëve apo dhe pretendimet e ortakeve ose aksionerëve mbi ndarjen e tepricës së likujdimit, kërkojnë investimin në këtë proces të likujduesit të zgjedhur në mënyrën e përcaktuar në ligj.

Në kushtet e plotësimit të kriterëve ligjore të sanksionuara në nenin 204 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", konkretisht vendimmarrjes për likujdimin e thjeshtëzuar të

shoqërise dhe parashtrimin me përgjegjësi të deklaratës së mungesës së detyrimeve ndaj kreditorëve dhe punemarresve, Gjykata vendos pranimin e kërkesës së kërkuarit për fillimin e procedurës së prishjes nëpërmjet procedurës së likuidimit të kësaj shoqërie tregtare.

Në lidhje me kërkimin me objekt për urdhërimin e Qendres Kombetare te Biznesit te heqi emrat e administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit të shoqërise EHW-KRIPA Sh.a., nga regjistri tregtar për shkak të përfundimit të afatit të mandatit të tyre, gjykata cmon se ky kërkim nuk mund të ngrihet në gjykatë dhe për këtë arsye do të pushohet.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të neneve 306, 309 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 187, 190 e në vijim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Gjykata

### V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Prishjen e shoqërisë aksionare EHW-KRIPA Sh.a., e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombetare të Biznesit, më datë 14.07.2008, me NUIS K81914035R dhe me seli në adresën Kashar, Superstrada Tirane-Durres, Km 4, Stabilimenti EHW, Tiranë, Shqipëri.

Fillimin e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësise paguese për shkak të prishjes së shoqërise EHW-KRIPA Sh.a., sipas pikës 1 të objektit të kësaj kërkesë dhe caktimin si likujdues të Ekspertit Kontabël Edvin Gaçe.

Pushimin e gjykimit për kërkimin me objekt për urdhërimin e Qendres Kombetare te Biznesit të heqë emrat e administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit të shoqërise EHW-KRIPA Sh.a., nga regjistri tregtar për shkak të përfundimit të afatit të mandatit të tyre.

Nje kopje e këtij vendimi pasi të marrë formë të prerë, t'i dërgohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës kërkuese.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, sot me date 06.06.2022.

**SEKRETARE**

**Klaudia ABAZAJ**

**GJYQTAR**

**Julian HAXHIU**

Vendimi mori formë të prerë pasi

nuk u ankimua më dt 29/06 2022.

Tiranë më dt 21/07 2022

Shpenzime gjyqësore  
Taksa kërkesë 200 leke  
Njoftime parapaguar pala kërkuese 150 leke  
Njoftime 150 Leke



K / SEKRETARE

**ADELA ÇINARI**